



*Forumi FOL HAPUR*

# Sfidat e Dialogut Kosovë-Serbi

Refleksion mbi karakterin dhe natyrën e dialogut  
3 QERSHOR 2011

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Royal Norwegian Embassy (RNE).  
Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e RNE.

### Përmbledhje:

Me qëllim që t'i kontribuojë diskutimeve publike, për çështje të rëndësishme dhe vitale për Kosovën, Lëvizja FOL ka nisur një forum të quajtur “FOL Hapur”, i cili, në ditët në vijim, do të trajtojë procese të rëndësishme politike dhe tematika të shumta eko- sociale.

Forumi i parë është zhvilluar sot, me një temë mjaft aktuale dhe me peshë të jashtëzakonshme për vendin tonë, “Dialogu Kosovë-Serbi”. Në këtë debat janë shtruar pyetje të shumta në lidhje me bisedimet Kosovë-Serbi. Më konkretisht, dialogu i tillë është analizuar nga këndvështrimi i transparencës dhe llogaridhënies, duke mos lënë anash edhe çështjen e arrestimit të fundit të Mlladiçit - pasojat që mund të prodhojë ky arrestim.

Në cilësinë e panelistëve, kanë qenë shef i departamentit të Shkencave Politike në UP, Bekim Baliqi, dhe publicisti e gazetari i Koha Ditore, Halil Matoshi.

Fillimisht, drejtori ekzekutiv i Lëvizjes FOL, Ramadan Ilazi, ka hapur diskutimin duke potencuar se qëllimi i këtij debati është të sjellë një perspektivë tjetër prej asaj politike të bisedimeve Kosovë-Serbi.

“Përvoja e Kosovës me negociata ka dëshmuar se proceset që nuk kanë pronësi publike mund të dështojnë, prandaj transparenca e tyre është qenësore, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të sigurohen se vendi do të përfitojë nga ky proces.”, ka thënë Ilazi.

Ndërkaq, analisti Matoshi tha se së paku shoqëria civile të flas hapur për këtë proces, kur dihet se në Kuvendin e Kosovës nuk ka pasur diçka serioze për këtë proces.

“Mendoj se nuk ka qenë koha e duhur për Kosovën që të hyjë në këto bisedime. Kuvendi i Kosovës duhet të miratojë një rezolutë me anë të së cilës do të kërkohej ndërprerja e bisedimeve deri në përmbushjen e disa kushteve nga Serbia, duke përfshirë edhe ndërprerjen e fushatës kundër Kosovës si dhe ndërprerjen e mbështetjes së strukturave paralele në Kosovë.”, pohoi ai.

Në anën tjetër, Shefi i departamentit të Shkencave Politike në UP, Bekim Baliqi, tha se nuk pajtohet me frikën se çfarë po humb Kosova dhe se çfarë po fiton Serbia nga këto bisedime.

“Ajo që dihet është se këto nuk janë bisedime, por negociata klasike. Më e rëndësishmja në këtë proces e që nuk po bëhet transparente është kohëzgjatja e këtyre bisedimeve, sepse nuk mund të negociohet pafundësisht për diçka”, tha Baliqi.

Konkluzionet e dala nga ky diskutim ishin se status quo në Kosovë po ndihmon krimin në veri të vendit, pastaj se Kosova është futur në negociata pa përgatitje paraprake të opinionit publik, pa strategji për pronësi publike në këtë proces si dhe është thënë se transparenca e këtyre bisedimeve është qenësore për të rritur mbështetjen e publikut për ndonjë marrëveshje eventuale.

## Sfida e dialogut Prishtinë - Beograd: parimet e panegociueshme dhe ideja e vjetër e ndarjes së Kosovës

### Halil Matoshi

Sfida e bisedimeve mes Prishtinës dhe Beogradit ngërthen tre çështje kryesore: Momenti kohor kur kanë filluar bisedimet Beogradi ka shumë favore ndërkaq që Prishtina disfavore, sepse ka një qeveri nder më të izoluarat në tërë Europën; Ekipi negociator kosovar nuk ka hedhur për diskutim në Kuvendin e Kosovës kurrfarë platforme dhe strategjie, që të zgjedhurit e popullit të mund të debatonin rreth faktit të thjeshtë se për çfarë po bisedon Prishtina me Beogradin, cilat janë interesat vitale kombëtare në këtë moment dhe cili është kufiri i fundit për kompromise;

Publiku është i privuar nga e drejta që të dijë në korniza të trasha se cilat janë ato marrëveshje që mund të arrihen me palën serbe dhe a kanë rrëshqitur bisedimet në negociata klasike politike, apo vërtet janë të nivelit teknik siç i paraqet Qeveria e Prishtinës;

A është çështja e pjesës veriore të Kosovës në tryezën e bisedimeve;

Sipas doktrinës serbe, me integrimin e veriut të Kosovës në institucionet e shtetit të ri shqiptarët do të ishin të vetmit fitues të gjithçkaje në Kosovë. Serbia e ka humbur luftën për Kosovën dhe kreu i saj politik dhe ushtarak e policor është ndëshkuar nga Tribunali i Hagës për krime lufte në ish Jugosllavi, e pse u dashka të fitojë diçka Serbia e cila,

po e ndjek “rrugën e fitores” sipas konditave të fashizmit të Millosheviqit? Dhe çka mund të fitojë ajo?

Veriun? Jo. Sepse kjo e shkatërron rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke e rizgjuar historinë dhe ulërimat e saj, boritë e luftës.

### **Ideja e vjetër e ndarjes së Kosovës -**

Kjo ide daton që nga viti 1976 (Libri i kaltër) dhe i përshkruhet Dobrica Qosiqit, i cili e parashihte ndarjen diku tek hekurudha e Ferizajt dhe kjo ndarje duhej të arrihej mes Serbisë dhe Shqipërisë, duke e shmangur në secilin rast Kosovën si entitet. Qosiq iu rikthye idesë së tij tashti në një version të ri: Libri i bardhë, që thërret për një marrëveshje historike mes serbëve dhe shqiptarëve, pra mes Beogradit dhe Tiranës, sërish duke e shmangur Kosovën si shtet i pavarur dhe për fat të keq edhe disa çarqe shqiptare po bien në kurthin e ngrehur nga Qosiqizmi, duke luajtur keq rolin e imperializmave të lodht..

Ndarja sipas versionit të parë serb deri në luftën e vitit 1999 ajo nuk mundi të realizohej, për arsye të efektit zinxhiror që do të kishte në ish republikat dhe krahinat tjera të ish Jugosllavisë. Ndërkaq që me intervenimin e NATO-s me 1999 u pengua jo vetëm gjenocidi në tentativë por edhe vetë ndarja territoriale e Kosovës, por po ashtu ideatori i fashizmit serb Millosheviq mendonte se do t’ia dilte ta mbante Kosovën si të plotë. Ndërsa sot në kushtet e paqes, ndarja e Kosovës e prishë Bosnjën Dejtoniane, Maqedoninë e brishtë e të ndarë etnikisht dhe implikon Serbinë rreth Luginës së Preshevës, pastaj vjen efekti domino, pra fut në

skemat apokaliptike Bullgarinë, Greqinë, Shqipërinë dhe Turqinë.

Kush mund ta paguaj këtë kosto? Askush.

Borko Stefanović tha se çelësi për zgjidhjen e problemit të Kosovës është veriu i saj, përderisa për 75 kombe të botës ky problem është zgjidhur më 1999 përkatësisht më 17 shkurt 2008 e ka marrë formën e vet kushtetuese dhe pas verdiktit të GjND-së edhe formën e vet juridike-ndërkombëtare.

**Tre parimet e panegociueshme të Grupit të Kontaktit** - Në këtë kontekst, ndërrimi i territoreve dhe bartja humane e popullsisë (Lugina e Preshevës) për shumë shqiptarë duket i pranueshëm, por vështirë i zbatueshëm paqësisht.

Në këtë rast duhet të rikujtohen tre parimet e panegociueshme të Grupit të Kontaktit, që të ndalen kalkulimet si në Beograd ashtu edhe në disa çarqe në Bruksel?

Problemi substancial i Kosovës është zgjidhur me shtet-krijim. Kosova i ka problemet e brendshme, korrupsionin galopant dhe krimin e organizuar, mungesën e shtetit ligjor dhe shmangien nga standardet demokratike, mosgarantimi i lirive civile dhe atyre ekonomike, etj. Në këtë rrafsh Qeveria e Kosovës duhet ta rivlerësojë rolin e vet në këto bisedime, nga të cilat Kosova nuk përfiton gjë, pos që transmeton lajme për kinse një problem të pazgjidhur.

Ose një konflikt të ngrirë. Këtu gabon Prishtina. Kosova është problem i zgjidhur dhe i ka në dorë punët e veta, sado që nuk po ia del t'i mbajë në dorë.

Pra Qeveria e Kosovës duhet të sillt si fituesja e vetme e luftës dhe ta hedhë para deputetëve të Kuvendit një strategji për mundësinë e vazhimit të bisedimeve, të cilat edhe ashtu po rrëshqasin në bisedime politike, gjë që shoqëria civile, përkatësisht Veton Surroi që në fillësë të tyre i ka cilësuar të tilla, politike.

Dhe tek tashti, kryenegociatorja kosovare, Edita Tahiri, e pranoi se Serbia i ka shndërruar ato në bisedime politike. Vonë dhe pandershëm. Pranohet diçka që moti është ditur dhe pranohet vetëm pasi rrjedh gjak nga trupat e kosovarëve!?

Qeveria e Kosovës duhet me urgjencë, për t'i mbrojtur interesat kombëtare të kosovarëve të dalë para Kuvendit me një platformë, e cila do të ndërtohej mbi parimet e paritetit.

1) Nuk ka tutje bisedime nëse Serbia nuk i inkurajon serbët kosovarë që të marrin pjesë në Institucionet e shtetit të ri dhe aty të luftojnë me mjete politike për të drejtat e tyre të ligjshme e të garantuara me Kushtetutë, si dhe për instalimin e demokracisë në vend, nga prizmi i patriotizmit ligjor; dhe nëse Beogradi nuk i shpërbën strukturat e veta paramilitare (paralele) në Kosovë;

2) Nuk ka tutje bisedime nëse Serbia vazhdon që të sillt armiqësisht, duke investuar në prishjen e stabilitetit të Kosovës madje edhe duke lobuar kundër njohjeve të reja ndërkombëtare vetë dhe përmes Ruisë (siç ndodhi aktualisht me njohjen që pritej nga Kenia);

3) Nuk mund të bisedohet me Beogradin nëse Serbia e bllokton Kosovën në

pikëpamje të tregut të lirë dhe nëse nuk i njeh dokumentet e udhëtimit të kosovarëve, gjë që, edhe pse nuk e kanë njohur shtetin e ri, “letrat” e kosovarëve i njohin edhe Sllovakia e Greqia.

4) Nuk mund të bisedohet për kopjet e kadastrave, përderisa origjinali është pronë e ligjshme e shtetit të Kosovës, sikur që nuk mund të bisedohet për kthimin e artefakteve arkeologjike dhe etnografike, përderisa ato ligjërisht janë pronë e kosovarëve;

5) Serbia duhet ta heq nga preambula e Kushtetutës së saj Kosovën si pjesë të Serbisë;

Pra këto janë postulate mbi të cilat mund të krijohet mirëbesimi për bisedime, dhe që këtu hedhet hapi i parë drejt shtendosjes mes Serbisë dhe Kosovës.

Me Serbinë nuk mund të bisedohet aktualisht për asgjë, përderisa nga Beogradi zyrtar nuk vijnë sinjale se Serbia po e ndërron radikalisht qasjen ndaj shtetit të ri;

Dhe në këtë vazhde Serbia dhe Kosova, nëse nuk kanë ende vullnet politik për ta ndihmuar njëra-tjetrën në integritet euro-atlantike, së paku të mos e pengojnë me asnjë veprim njëra tjetrën.

Deri atëherë, bisedimet duhej ndërprerë, sepse ato nuk po sjellin asnjë lajm të mirë në Prishtinë, pos sherreve, përplasjeve brenda shoqërisë kosovare dhe ndjenjës armiqësore mes dy popujve. Kjo nuk do të thotë njohje e shpejtë dhe e pakusht e Kosovës nga Serbia. Por kjo do të thotë se Serbia nuk e ka ndërmend tutje të eksportojë dhunë në Kosovë.

Serbia do të përpiqet që letrën e veriut ta ruaj për fund, për t’ia shitur BE-së tek pasi ta marrë statusin e vendit kandidat, më shtrenjtë se vet kriminelin e luftës Ratko Mladic - pra heqjen dorë nga veriu do ta kushtëzojë me pranimin në bllok, deri atëherë lë ta harron secili në Prishtinë se mund të përdoret forca (madje as sipas memorandumit mes Policisë dhe FSK-së.)

### **Sfida e dialogut Prishtinë - Beograd: Bisedime apo Negociata?**

#### **Prof.Dr.Bekim Baliqi**

Duke u nisur nga fakti se këto bisedime janë të një rëndësie jetike për shtetin e Kosovës dhe për vetë qytetarët e saj, këto kërkojnë një debat më të gjere publik e politik. Prandaj, diskutimet e bëra nga ana e shoqërisë civile, raportimet e medieve mbi këto bisedime janë në funksion të informimit të qytetarëve dhe transparencës më të madhe rreth këtyre bisedimeve. Dilemat që dalin rreth këtyre janë të shumta dhe e hutojnë paksa opinionin publik. Duke filluar së pari prej vetë emërimit, pra a janë këto biseda apo negociata, apo a janë vërtet teknike apo politike?!

Qartësimet që duhet të ndodhin vetëm se do t’i kontribuojnë vetë këtij procesi negociues, dhe këto duhet të ndodhin në disa rrafshe;

Nën një, konsideroj se afatet kohore apo një kornize se sa do të zgjasin këto bisedime/negociata duhet të jenë të përcaktuara. Kujt i konvenon tejzgjatja e këtij procesi? Unë besoj se pikërisht

Serbia është e interesuar që këto zgjasin sa më shumë, edhe atë për disa arsye. Pikësëpari, për shkak të afrimit më të madh me Brukselin, pastaj raporteve të politikës së brendshme, etj.

Qëndrimet- përveç vijave të kuqe të njohura për publikun, do të ishte e udhës që të dihet edhe rreth qëndrimeve me konkrete për tema specifike. Në këtë kontekst, dilema që lind ka të bëjë me atë se ku është mesi i “arte” në mes të pozicioneve diametralisht të kundërta të Beogradit dhe Prishtinës? Si dhe pyetja tjetër që shtrohet ka të bëjë me atë se sa dhe si ndikojnë këto bisedime në konstelacionin politik në Serbi dhe atë në Kosovë.

Element shumë i rëndësishëm këtu është edhe roli i ndërmjetësuesit, respektivisht fuqisë realpolitike të Brukselit që t’i joshë apo shtyjë palët për marrëveshjet eventuale. Dhe brenga tjetër ka të bëjë me atë se pse SHBA nuk janë pjesë e ndërmjetësimit dhe mediatimit në këto negociata. Dhe, përfundimisht, aspekti qenësor në këto bisedime/negociata do të jetë çështja e kompromiseve apo marrëveshjes. A nënkupton kompromisi kompensim apo zgjidhje 50 përqindëshi, ku nuk kënaqet asnjë palë, por gjendet konsensusi më i pranueshëm nga të dyja palët? Si do të reflektojë kjo në shtetësinë e Kosovës. Këtu, mendoj se Serbia i hedhë në tavolinë idetë e ndryshme me qëllim të arritjes se një autonomie për serbet në pjesën veriore të Kosovës, duke u bazuar pak a shume në „modele“ të vendeve tjera.

Pra, përfundimisht, sfidat që priten në këtë proces janë të shumta dhe të

panjohurat edhe më të mëdha. Kështu që, këto bisedime duhet të prodhojnë rezultate konkrete sa më parë, në mënyrë që të mos dështojnë krejt. Ose, në rastin më pozitiv, ato mund të jenë gjenerues të një paqe dhe stabilizimi të raporteve Kosovë-Serbi, nëse palët arrijnë të gjejnë zgjidhje konstruktive në të mirë të qytetarëve të dyja vendeve. Por, kjo kërkon një angazhim më të fuqishëm të Brukselit dhe qëndrime më pragmatike të Beogradit.

## Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Royal Norwegian Embassy. Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar të lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë webfaqe: [www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

## Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

## Kontakto:

Andrea Gropa 35, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Mob: +377 (0) 44 131 542  
Web: [levizjafol.org](http://levizjafol.org)  
E-mail: [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org)

*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry*